

Korrik 2025

Nr . (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
39	03.07.2025	Kërkesë për informacione lidhje: Çfarë standardesh ligjore ka Shqipëria për përdorimin e mjeteve lundruese pranë zonave të plazhit ku lahen pushuesit? · Kush ka përgjegjësinë për zbatimin e këtyre standardeve dhe si monitorohen në praktikë? · A ekziston një kufi distancor i përcaktuar për mjetet e motorizuara (jet ski, gomone etj.) pranë vijës bregdetare ku notojnë njerëzit? · A ka patrulla apo inspektime të përhershme që kontrollojnë respektimin e këtyre rregullave gjatë sezonit turistik? · Sa aksidente detare janë raportuar në 3 vitet e fundit në zonat turistike të Shqipërisë? · A mund	15.07.2025	Në lidhje me qarkullimin e mjeteve lundruese, sqarojmë se subjektet mund të operojnë nëpërmjet vendqëndrimeve ose stacioneve sezonale të ankorimit/ bregëzimit. Vendqëndrimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre, miratohen nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar, neni 4, pika 1/ ç, pika 2 që përcakton: <i>Harta e përgjithshme për plazhet e lejuara</i> Njësitë e vetëqeverisjes vendore përgatisin hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara. Kjo hartë përmban, si më poshtë vijon: ç) vendqëndrimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre. Për përcaktimin e vendqëndrimeve dhe korridoreve të lëvizjes, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, njësitë	Përfunduar	0

		të bëhen publike të dhënat mbi shkaqet më të zakonshme të këtyre aksidenteve? · A ka viktimë të huaj ndër turistët dhe si janë menaxhuar rastet nga autoritetet shqiptare? · Çfarë masash po ndërmerr ministria për të përmirësuar sigurinë në plazhe për këtë sezon? · A ka programe informuese ose fushata sensibilizuese për turistët dhe operatorët e mjeteve detare? · A planifikohen investime për rritjen e numrit të rojeve bregdetare dhe trajnimin e tyre? · Si bashkëpunon Ministria e Turizmit me Ministrinë e Brendshme, Policinë Kufitare dhe Portuale, dhe bashkitë për garantimin e rendit dhe sigurisë në plazhe? · Kush mban përgjegjësi kur ndodhin aksidente, pronarët e mjeteve, operatorët turistikë, apo ndonjë institucion publik? · A mendoni se këto aksidente mund të dëmtojnë imazhin turistik të Shqipërisë? Çfarë strategjie keni për të ruajtur besimin e turistëve?	e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe me strukturat e Policisë Kufitare. Në nenin 9, të VKM-së 649/2024 të ndryshuar, pika 4, përcaktohet se: 4. Të gjitha stacionet e plazhit duhet të kenë: a) sinjalizimin dhe kufizimin me bova, me diametër 22 cm, me ngjyrë të kuqe, të lidhura me litar pluskues me njëra-tjetrën, çdo 30–50 m të hapësirës ujore përpara stacionit të plazhit të dedikuar për not, e cila duhet të jetë deri në: i. 200 (dyqind) m nga bregu për plazhet e tipit A; ii. 100 (njëqind) m nga bregu për plazhet e tipit B, deri në thellësinë 1.6 m (një pikë gjashtë) të vendosen bova, me diametër 22 cm, me ngjyrë të bardhë, e cila sinjalizon pushuesit për zonën e sigurt për notim. Bovat duhet të jenë të mirankoruara dhe të kontrollohen periodikisht, nëse ato kanë lëvizur nga pozicioni i tyre nga dallgët, era apo shkaqe të tjera. b) sinjalizimin e zonave të përdorimit të mjeteve lundruese për argëtim, zonat për përdorimin dhe vendqëndrimin e mjeteve lundruese me ose pa motor, jashtë zonave të përcaktuara për not sipas shkronjës “a”, më sipër, duhet të jenë të kufizuara, duke ofruar vende për qëndrim në tokë dhe bova për përcaktimin e vendqëndrimeve dhe korridoreve për afrimin dhe parkimin në tokë të mjeteve ujore me ose pa motor. Në zonat e përdorimit dhe vendqëndrimeve të mjeteve lundruese për argëtim, aktivitetet e notimit janë të ndaluara. Sinjalizimin me tabela informuese në shqip dhe në anglisht, në vend të dukshëm pranë bregut të detit “Zonë e ndaluar për notim” dhe “<i>No swimming area</i>”; Në lidhje me operatorët e turizmit detar, Ju bëjmë me dije se:		
--	--	--	--	--	--

				Asnjë operator, i cili ushtron veprimtari ekonomike dhe nuk disponon certifikimin përkatës si operator i turizmit detar, nuk duhet lejuar nga strukturat e Policisë Kufitare të ushtrojnë veprimtari lundruese., duke bërë në këtë mënyrë dhe ndarjen me qytetarët që kanë një mjet lundrues për përdorim personal për qëllime turizmi dhe që lejohet të lundrojnë në zonën ujore, por pa prekur zonën e notimit. Siguria e turizmit detar ka qenë në prioritet të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ku në tre vitet e fundit janë certifikuar mbi 170 operatorë turistikë detarë të cilët plotësojnë standardet dhe kërkesat sipas kuadrit ligjor në fuqi, krahasuar me më pak se 10 operatorë të turizmit detar të certifikuar deri në vitin 2022. Certifikimi i operatorëve të turizmit detar nuk i referohet personave fizik privat që disponojnë një mjet lundrues, por subjekteve të licencuara nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas nenit 5, të ligjit nr. 43/2020 “<i>Për aktivitetet e turizmit detar</i>”, të ndryshuar, i cili përcakton: <i>1. Aktivitetet e turizmit detar për qëllime çlodhëse dhe argëtuese, me përjashtim të peshkimit turistik, ofrohen vetëm nga operatorët e turizmit detar të licencuar dhe që ofrojnë për klientët shërbime për ushtrimin e aktiviteteve të përcaktuara nga ky ligj.</i> <i>2. Operatori i turizmit detar është operatori turistik i licencuar në përputhje me ligjin për turizmin, ligjin për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë dhe parashikimet e këtij ligji, me kusht që të ofrojë shërbime për, të</i>		
--	--	--	--	--	--	--

				paktën, një nga aktivitetet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 3, të këtij ligji. 3. Operatori i turizmit detar, para fillimit të aktiviteteve të turizmit detar, pajiset me certifikatë për ushtrimin e këtyre veprimtarive nga ministria përgjegjëse për turizmin. Kriteret dhe procedura për certifikimin përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për turizmin. 4. Operatorët janë përgjegjës për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe mospërmbushja e tyre i ngarkon me përgjegjësi administrative, sipas nenit 24, të këtij ligji. 1. 4. “Operatorët e turizmit detar”, sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar”, duhet të regjistrohen në regjistrin e mjeteve lundruese dhe detare, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare, në përputhje me parashikimet e Kodit Detar dhe legjislacionin në fuqi. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, si institucion varësie i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, inspekton vetëm pajisjen me certifikatën përkatëse të operatorit të turizmit detar. 1. 5. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 127/2020 “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit”, kontrolli dhe verifikimi i dokumentacionit të mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit ushtrohet nga Policia Kufitare dhe e Migracionit. Mjetet lundruese mund të operojnë vetëm në zonat e përcaktuara për ushtrimin e kësaj		
--	--	--	--	--	--	--

				veprimtarie dhe qarkullimi i tyre në zonën e bregdetit është i ndaluar. Për gjendjen e mjeteve lundruese, dokumentacionin e tyre dhe korridoret hyrëse dalëse, Policia kufitare bashkëpunon ngushtësisht dhe me Drejtorinë e Përgjithshme Detare. Gjithashtu, është krijuar një flotë e posaçme në varësi të Policisë Kufitare dhe Migracionit për patrullimin dhe kontrollin e operatorëve turistikë detar. Informimi i operatorëve është bërë nëpërmjet strukturave të varësisë, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, me qëllim certifikimin dhe disiplinimin e lëvizjes së tyre. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet komunikimit publik, si dhe strukturave të varësisë, përfshirë dhe Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, kanë vijuar me informimin dhe këshillimin e operatorëve turistikë, mbi zbatimin e kuadrit ligjor për ushtrimin e veprimtarive turistike. Informimi dhe ndërgjegjësimi, vlen t'i drejtohet edhe pushuesve, mbi respektimin e sinjalistikës që vendoset nga vrojtuesit e plazhit përsa i përket kushteve të notimit, në varësi të kushteve të motit. Gjithashtu, prania e vrojtuesve të certifikuar në stacionet e plazhit është e detyrueshme. Prania e vrojtuesit të plazhit është kusht për nënshkrimin e kontratës për përdorimin e hapësirës së plazhit nga subjektet. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, mund të procedojë me nënshkrimin e kontratës për përdorimin e hapësirës së plazhit, me subjektet vetëm pas paraqitjes nga ana e tyre, të marrëveshjes së noterizuar me vrojtuesin e plazhit (shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit).		
--	--	--	--	--	--	--

				Përsa i përket aksidenteve të mundshme në hapësirën ujore nga subjektet që ofrojnë shërbime të turizmit detar, ato janë subjekt i hetimeve nga institucionet përkatëse sipas kuadrit ligjor të Shqipërisë.		
40	04.07.2025	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentacionit zyrtarë	08.07.2025	Kthyer përgjigje me shkresë	Përfunduar	0
41	07.07.2025	Kërkesë për informacione lidhje: 1. A është bërë matja e ndotjes nga zjarri në impiantin e trajtimit të mbetjeve në Elbasan? Nëse po, cilat kanë qenë rezultatet? 2. Cilat janë përmasat e ndotjes? Cila është shtrirja e ndotjes? 3. Cila është situata e trajtimit të mbetjeve në Fier dhe Tiranë, ku po funksionon procesi i incenerimit dhe ky jo? Nëse jo cilat janë arsyt.		Ne proces		
42	07.07.2025	Nepermjet ketij emai, si pjesëtar i organizatës PPNEA , kërkoj të kem në dispozicion informacion lidhur me hapat që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndërmarrë në përgjigje të rekomandimeve të <u>Komitetit të Përhershëm të Konventës për Ruajtjen e Specieve të Migrimit të</u>		Ne proces		

		<u>Egër (CMS)[1]</u>, në lidhje me projektin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës. <u>Kërkoj nga ana juaj të na vini në dispozicion raporte, vendime dhe informacione</u> që lidhen me zbatimin e cdo pike të rekomandimit që Komiteti i Përhershëm ka referuar për vendin tonë në dokumentin e rekomandimeve të aksesueshëm në footnote nr. 1, ku në total janë 6 pika				
43	07.07.2025	Nepermjet ketij emai, si pjesëtar i organizatës PPNEA , kërkoj të kem në dispozicion informacion lidhur me hapat që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndërmarrë në përgjigje të <u>Rekomandimit Nr. 219 (2023) të Konventës së Bernës</u>, në lidhje me projektin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës. <u>Kërkoj nga ana juaj të na vini në dispozicion raporte, vendime dhe informacione</u> që lidhen me zbatimin e cdo pike të rekomandimit që Komiteti i Përhershëm ka referuar për vendin tonë në dokumentin e		Ne proces		

		rekomandimeve të aksesueshëm në attach, ku në total janë 11 pika.				
44	12.07.2025	Kerkese per informacion lidhur: me incidentet mjedisore të ndodhura gjatë viteve buxhetore 2021, 2022 dhe 2023, të cilat kanë pasur, kostot më të larta për Ministrinë tuaj në drejtim të masave riparuese (rehabilituese). Informacioni që kërkojmë të na vihet në dispozicion është: 1. Lista e 5 incidenteve mjedisore më të kushtueshme për Ministrinë tuaj, duke specifikuar për secilin incident: o Përshkrimin e shkurtër të incidentit mjedisor (vendndodhjen, natyrën e ngjarjes, datën e ndodhjes). o Koston totale financiare që Ministria juaj ka paguar për marrjen e masave riparuese		Ne proces		

		(rehabilituese) të incidentit në fjalë. 2. Kopje të raporteve që Ministria juaj ka përgatitur në lidhje me secilin prej këtyre 5 incidenteve, nëse ekzistojnë.				
45	14.07.2025	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentacionit zyrtarë	17.07.2025	Kthyer pergjigje me shkres zyrtare	Perfunduar	0
46	23.07.2025	Kerkese per informacion ne lidhje me: ➤ Direktivës së BE-së për Habitave (92/43/EEC) dhe ➤ Direktivës së BE-së për Zogjtë (2009/147/EC) • <i>Hapat konkretë që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndërmarrë për transpozimin e këtyre dy direktivave në legjislacionin kombëtar;</i> • <i>Nëse këto direktiva janë përafruar në mënyrë të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;</i> • <i>Hapat që janë ndërmarrë ose planifikohen për zbatimin praktik dhe institucional të kërkesave të tyre;</i>		Ne proces		

		Nëse ekziston një buxhet i dedikuar apo fonde specifike të alokuara nga institucioni juaj për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga këto dy direktiva.				
--	--	--	--	--	--	--

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

(1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.

(2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.

(3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

(5) Ndhmon kërkesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.